



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 maj 2013
Nr. ref.: RK413/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI31/13

Parashtruesi

Ramadan Muja

Ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren
C. nr. 516/07 të 12 nëntorit 2007

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Ramadan Muja, fshati Strazhë, komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 516/07 të 12 nëntorit 2007.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon ekzekutimin e aktgjykimeve që kanë të bëjnë me të drejtat e tij e fituara. Megjithatë, ai nuk përmend se cilat të drejta kushtetuese i janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e Punës).
5. Më 16 prill 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 mars 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 mars 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama Hajrizi.
8. Më 2 prill 2013, Gjykata Kushtetuese përmes një shkrese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Gjykatës Themelore në Prizren, si pasardhëse e Gjykatës Komunale në Prizren.
9. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 5 qershor 1969, parashtruesi kishte themeluar marrëdhënie pune në ndërmarrjen tregtare „Sredačka Župa“ në Prizren dhe për shkak të disa konflikteve ai kishte iniciuar procedurë përmes gjykatave të rregullta me qëllim që të realizonte të drejtat e pretenduara.

11. Pas një kohe të gjatë, më 24 korrik 2006, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës duke kërkuar që ta obligojë ndërmarrjen “Sredačka Župa” që parashtruesit t’ia paguajë shumën prej 19.568,22 Euro.
12. Më 2 korrik 2007, Dhoma e Posaçme nxori vendim (Lënda SCC-06-0344) për t’ia referuar *“këtë çështje Gjykatës Komunale në Prizren dhe kështu duke ia dhënë kompetencën kësaj gjykate që të vendos për këtë çështje. Në rast se vendimi ose aktgjykimi i kësaj gjykate ankimohet, ankesa parashtrohet në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.”*
13. Në fakt, ky vendim ishte marrë *“në bazë të nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 dhe nenit 17 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2006/17, Dhoma, pavarësisht nga kompetencat e veta, mund t’i referojë paditë specifike ose kategoritë e padive cilëso gjykate që ka juridiksion për atë çështje sipas ligjit në fuqi, sipas kërkesës së palës ose sipas iniciativës së vet nëse është e bindur se janë përmbushur kushtet nga neni 17.(b). Kushtet janë si në vijim:*

Dhoma e Posaçme është e bindur se gjykata së cilës i referohet kërkesëpadia do të sjellë vendim të paanshëm duke pasur parasysh:
(i) natyrën e palëve;
(ii) vlerën e shumës kontestuese dhe
(iii) rrethanat tjera të kërkesëpadisë”.
14. Më 12 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Prizren nxori aktgjykimin [C.no.516/07], duke e urdhëruar “Sredačka Župa” që parashtruesit t’ia paguajë borxhin për të ardhurat personale për periudhën prej 4 qershorit 1990 deri më 2 shkurt 1998, në shumë prej 19.568,22 Euro ku përfshihen edhe shpenzimet për ekspertizën dhe për procedurën gjyqësore.
15. Më 1 prill 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) e njoftoi Gjykatën Komunale në Prizren *„se në pajtim me nenin 2.1 të Ligjit nr. 03/L-067, ajo është e autorizuar për administrimin duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të përkufizuara në këtë ligj.”* Në përfundim të shkresës thuhet se: *“Agjencia do t’i shqyrtojë të gjitha kërkesat, duke përfshirë edhe kërkesën e parashtruesit për realizimin e të drejtave të tij, vetëm nëse parashtruesi paraqet kërkesë para komisionit për likuidim, në pajtim me dispozitat e ligjit.”*
16. Më 10 janar 2011, AKP e informoi parashtruesin se *“likuidimi i ndërmarrjes ‘Župa Rečane’ ka filluar më 31 dhjetor 2010 dhe se të gjitha obligimet ndaj parashtruesit, duke përfshirë të gjitha rrogat e papaguara të cilat punëdhënësi ia ka borxh në bazë të kontratës për punësim, do të trajtohen sipas rregullores së likuidimit”.*
17. Më 28 janar 2011, AKP kërkoi nga parashtruesi: *“të konfirmonte se kërkesa juaj mbetet e pandryshuar nga dita e likuidimit (...)”* dhe *“plotësoni formularin e kërkesës të bashkëngjitur (...)”.* Parashtruesi duhet ta kthejë formularin e kërkesës për likuidim *“më ose para 20 marsit 2011”.*

18. Më 21 shkurt 2011, parashtruesi ia ktheu AKP-së formularin e paraqitjes së kërkesës për likuidim.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi deklaron se, edhe përkundër faktit se vendimet gjyqësore janë në dobi të tij, ai nuk po mund t'i realizojë të drejtat e veta që 23 vjet.
20. Parashtruesi pretendon se *“më 31 dhjetor 2010, ne, të gjithë punëtorët u informuam dhe pranuan vendimin se ndërmarrja jonë është në procedurën e likuidimit dhe se të gjithë jemi të larguar nga puna, dhe se ndërmarrjes duhet t'ia paraqesim paditë tona, dhe se në afat prej tre muajsh do të jemi të njoftuar për vlerësimin e kërkesave tona, 2 vjet kaluan, nuk morëm kurrfarë njoftimi as ndonjë provë valide se ata i kanë pranuar dokumentet (...).*
21. Parashtruesi gjithashtu pretendon: *“Unë nuk i di dispozitat kushtetuese, unë nuk jam jurist, në këtë kërkesë e kam paraqitur veten time si fshatar dhe besoj se ju më kuptoni”.*
22. Parashtruesi më tutje pretendon se brenda afatit ligjor e ka dërguar dokumentacionin e kërkuar në AKP por që dy (2) vjet është duke e pritur përgjigjen.
23. Me një fjalë, parashtruesi kërkon që t'i paguhet të gjitha rrogat e papaguara, siç është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren [C.no.516/07] të 12 nëntorit 2007, duke përfshirë të drejtën e 20% i cili i takon sipas Ligjit për privatizim.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Para së gjithash, për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat parashihen me Kushtetutë dhe specifikohen më tej me Ligj dhe Rregullore të Punës.
25. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës cili parasheh se:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Në anën tjetër, neni 47(2) i Ligjit gjithashtu përcakton se:

Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

27. Për më tepër, rregulli 36(1) a) i Rregullores së Punës parasheh se:

Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimin të

kundërshtuar.

28. Parashtruesi pohon se brenda afatit ligjor e ka dërguar dokumentacionin e kërkuar nga AKP-ja. Megjithatë, parashtruesi është duke pritur përgjigjen që nga 21 shkurti 2011, dita kur e ka dërguar dokumentacionin. Kjo do të thotë se çështja është ende e pazgjidhur në AKP dhe shterja e mjeteve juridike të përcaktuara me ligjin në fuqi ende nuk është përmbushur.
29. Gjykata rikujton se ajo mund të vendosë për pranueshmërinë e kërkesës vetëm nëse parashtruesi/ja tregon se ai/ajo i ka shterur të gjitha mjetet juridike efektive që i ka në dispozicion në bazë të ligjit në fuqi.
30. Në fakt, parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi t'i shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt me qëllim që të parandalohet shkelja e Kushtetutës ose, nëse ka shkelje të një të drejte themelore, e njëjta të korrigjohet.
31. Arsyeja për rregullin e shterimit është që autoritetet përkatëse, përfshirë këtu edhe AKP-në të kenë mundësi për të parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë një mjet efektiv kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. (Shih Aktvendimi për papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës KI-41/09 i 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).
32. Në fakt, si rregull i përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese intervenon aty ku ka shkelje të interpretimit të Kushtetutës ose ku ligjet nuk përputhen me Kushtetutën, por vetëm pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
33. Andaj, kërkesa, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47(2) të Ligjit dhe rregullit 36(1) a) të Rregullores së Punës, është e parakohshme dhe si e tillë e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36.2 dhe 56 të Rregullores së punës, më 27 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani